





Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar


Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të aksit rrugor “Vlorë -Vllahinë- Poçëm - Selenicë”, “Vlorë-Zvërnec” dhe “Vorë – Kepi i Rodonit”.

Fotografimi 360° i gjeoreferencuar gjen përdorim në fusha dhe projekte të larmishme si:

- Evidentimi dhe mirëmbajtja e sistemit rrugor;
- Kontrolli i mirëmbajtjes së akseve rrugore të cilat i janë kontraktuar operatorëve ekonomikë;
- Kontrolli i investimeve të kryera në akse rrugore (sinjalistikë, gjelbërim, ndriçim, etj.);
- Përcaktimi i zonave që kërkojnë ndërhyrje në kuadër të mirëmbajtjes;
- Dokumentimi fotografik i etapave të ndërtimit të veprave të infrastrukturës, objekteve të ndryshme arkitektonike dhe hapësirave publike;
- Promovimi i turizmit;
- Evidentimi i objekteve social – ekonomike.



Publikim i informacionit gjeohapësinor për temën “Përdorimi i Tokës” në Gjeoportalin Kombëtar



ASIG në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), si autoritet publik përgjegjës për temën “Përdorimi i Tokës”, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresat:

- Kufi njësie strukturore dhe përdorimi i tokës,
- Kategoritë e propozuara të përdorimit të tokës,
- Plani gjeohapësinor.

Këto shtresa përbajnë Planet e Përgjithshme Vendore ku përfshihen të dhëna të cilat përcaktojnë kategoritë e propozuara të përdorimit të tokës.

Për të aksesuar këto shtresa në Gjeoportalin Kombëtar [klikoni këtu](#).

Takim mes ASIG dhe përfaqësues të biznesit në fushën e turizmit të Qarkut Gjirokastrë

Drejtori i Përgjithshëm i ASIG, znj. Vilma Tomço zhvilloi një takim me një grup përfaqësuesish të 75 bizneseve që operojnë në fushën e turizmit në Qarkun Gjirokastrë. Qëllimi i këtij takimi ishte evidentimi, diskutimi dhe koordinimi për zgjidhjen e një sërë problematikash që lidhen me përditësimin e të dhënave infrastrukturore në sistemin maps. Fillimi i sezonit turistik nxjerr në pah nevojën për një orientim më të saktë të turistëve dhe vizitorëve, duke evituar në maksimum keqinformimin e tyre me informacione të pa përditësuara, referuar edhe investimeve të shumta të kohëve të fundit në infrastrukturën rrugore.

ASIG ka prioritet bashkëpunimin me të gjithë aktorët dhe institucionet, duke garantuar përditësimin e të dhënave në rang kombëtar.



TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

Në kuadër të nismës së ndërmarrë nga ASIG me qëllim rritjen e kapaciteteve të 61 Bashkive të vendit, ekspertë të ASIG realizuan gjatë këtij muaji, trajnime me stafet teknike të bashkive të Republikës së Shqipërisë, si më poshtë:

- Bashkia Lezhë;
- Bashkia Elbasan;
- Bashkia Shkodër;
- Bashkia Malësia e Madhe;
- Bashkia Vau i Dejës;
- Bashkia Kavajë;
- Bashkia Rrogozhinë;
- Bashkia Lushnjë.

Tematikat e trajtuara në këto trajnime janë:

1. Njohja me funksionalitetet e Gjeoportalit Kombëtar;
2. Mbledhja e të dhënave sipas temave të gjeoinformacionit për: Njësitë administrative dhe fshatrat në përbërje të tyre (rendi 4 dhe 5), Rrjeti i transportit rrugor lokal;
3. Prezantimi i produkteve të përftuara nga projekti i Shërbimit Satelitor.

Kjo nismë do të vijojë në të gjitha bashkitë e vendit, përgjatë periudhës në vazhdim.



Takim mes ASIG dhe përfaqësuesve të International Telecommunication Union

Drejtori i Përgjithshëm i ASIG, znj. Vilma Tomço zhvilloi një takim pune me drejtuesin e zyrës së International Telecommunication Union (ITU) për Evropën z. Jaroslav Ponder dhe z. Elind Sulmina Projekt Oficer i ITU.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi mundësitë e bashkëpunimit në projekte të ndryshme të fushës së zhvillimit të infrastrukturës broadband dhe asaj të gjeoinformacionit.



Workshop "Digital Innovation Profile for Albania"



Përfaqësues të ASIG morën pjesë në workshop-in "Digital Innovation Profile for Albania" (DIP), të organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me ekspertët e Byrosë së Zhvillimit të Telekomunikacionit (BDT) të International Telecommunication Union (ITU). Qëllimi i këtij workshop-i ishte krijimi i një Profili Digjital Inovativ, i cili synon të sigurojë një vlerësim të saktë të kapacitetit të ekosistemit të vendit tonë, për të ndihmuar palët e interesuara të eksplorojnë rrjedhën e inovacionit dhe të ndërtojnë një ekonomi të qëndrueshme të mbështetur nga Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit.

BOTA E GJEONFORMACIONIT

Hartat bazë të ArcGIS të Esri-t të integruara në Autodesk Civil 3D dhe AutoCAD

Profesionistët e Arkitekturës, Inxhinierisë dhe Ndërtimit (AEC), tashmë kanë qasje në të dhënat e pasura, autoritative të referencës gjeohapësinore të Esri me paketën e produkteve Autodesk. Sektori i AEC po mbështetet gjithnjë e më shumë në ndërveprimin e sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe modelimit të informacionit të ndërtesave (BIM) për të reduktuar kostot dhe për të rritur efikasitetin në projektet e ndërtimit. Integrimi i ArcGIS Basemaps me Civil 3D dhe AutoCAD u ofron profesionistëve të AEC të dhëna të detajuara gjeohapësinore duke përmirësuar aftësitë e tyre hartografike.

EUSPA merr në dorëzim satelitët më të fundit Galileo në fazën e nisjes dhe të orbitës së hershme (LEOP), pas vendosjes së tyre të suksesshme në orbitë

EUSPA (Agjencia e Bashkimit Evropian për Programin Hapësinor) po mbikëqyr fazën vendimtare të nisjes dhe të orbitës së hershme (LEOP), pas lëshimit të fundit të dy satelitëve të rinj Galileo. Përfshirja e këtyre dy satelitëve të rinj, grumbullon gjithësej tridhjetë satelitë Galileo në orbitë, duke ofruar përmirësime të vazhdueshme për shërbimet e tyre. Në vijim, ekipet EUSPA dhe SpaceOpal do të vënë në punë nënsistemet dhe do të manovrojnë satelitët deri në fillimin e fazës së zhvendosjes, e cila do të zgjasë rreth katër javë me manovrat Drift Stop dhe Fine Positioning (DSFP) për të finalizuar alokimin e tyre në orbitë.

AKTIVITETE NË VIJIM

AGILE 2024

Shoqata e Laboratorëve të Informacionit Gjeografik në Evropë (AGILE) organizon në Glasgow të Mbretërisë së Bashkuar, konferencën e 27-të me temë "Shkenca e Informacionit Gjeografik për një të Ardhme të Qëndrueshme". Ky aktivitet synon të eksplorojë rolin kritik të shkencës së informacionit gjeografik në formësimin e një të ardhmeje të qëndrueshme.

4-7 Qershor 2024

www.asig.gov.al

GEO Business

GEO Business është një platformë e cila bën bashkë komunitetin gjeohapësinor për të zbuluar potencialin e tij të inovacionit. Pjesëmarrja në këtë aktivitet i cili do të zhvillohet në Londër, të Mbretërisë së Bashkuar, ju jep mundësinë pjesëmarrësve të zbulojnë zgjidhje të reja në fushën e gjeoinformacionit, si dhe të shkëmbejnë pikëpamjet dhe përvojat e tyre.

5-6 Qershor 2024

FOSS4G Europe 2024

Konferenca FOSS4GE, një ngjarje vjetore e Fondacionit Gjeohapësinor me Burim të Hapur (OSGeo), do të zhvillohet në Tartu të Estonisë. Ky aktivitet bashkon profesionistë të fushës së softuerit të gjeoinformacionit duke u fokusuar tek gjeoinformatika, hartografia dhe standardet e hapura, për të nxitur data sharing dhe zgjidhje inovative të problematikave të këtyre fushave.

1 - 7 Korrik 2024

www.geoportal.asig.gov.al